



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3282 / Prot

Rrëshen, më 05 . 08 . 2026

V E N D I M

Nr. 62 datë 29. 07. 2026

P Ë R

**“MIRATIMIN E DRAFT - MEMORANDUMIT PËR PARTNERITET DHE
BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË NDËRMJET; BASHKISË MIRDITË DHE
KOMUNËS NOVA RAÇA, REPUBLIKA E KROACISË”**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 9, 14, pikat “3” & “4”, neni 54, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 8548, datë 11.11.1999, “Për ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, *Relacionin nr. 3282, datë 17.07.2026 & marrëveshjes së binjakëzimit nr. 11322 prot, datë 27.07.2026 dhe Draft - Memorandumit*, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, pas shqyrtimit dhe diskutimeve në mbledhjen e Këshillit Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Draft - Memorandumit për Partneritet dhe Bashkëpunim të Ndërsjellët ndërmjet; Bashkisë Mirditë dhe Komunës Nova Raça, Republika e Kroacisë, sipas marrëveshjes së binjakëzimit nr. 11322 prot, datë 27.07.2026 & Draft - Memorandumit, bashkëlidhur, *pjesë përbërse e këtij vendimi*
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Mirditë për nënshkrimin e Memorandumit dhe për kryerjen e veprimeve administrative, të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Zbatimi i nismave, projekteve ose aktiviteteve që sjellin detyrime financiare për Bashkinë Mirditë do të bëhet vetëm pas miratimit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me fondet e miratuara në buxhetin vendor.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe strukturat përgjegjëse të administratës së Bashkisë Mirditë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3282/Prot.

Rrëshen, më 17.07.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. 68, datë 17.07.2026

PËR

**“MIRATIMIN E DRAFT-MEMORANDUMIT PËR PARTNERITET DHE
BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLË NDËRMJET BASHKISË MIRDITË DHE KOMUNËS
NOVA RAÇA, REPUBLIKA E KROACISË”**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 9, nenit 14, pikat 3 dhe 4, dhe nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, Këshilli Bashkiak Mirditë

VENDOSI:

1. Miratimin e Draft-Memorandumit për Partneritet dhe Bashkëpunim të Ndërsjellë ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe Komunës Nova Raça, Republika e Kroacisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Mirditë për nënshkrimin e Memorandumit dhe për kryerjen e veprimeve administrative të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Zbatimi i nismave, projekteve ose aktiviteteve që sjellin detyrime financiare për Bashkinë Mirditë do të bëhet vetëm pas miratimit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me fondet e miratuara në buxhetin vendor.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe strukturat përgjegjëse të administratës së Bashkisë Mirditë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETAR

Gaspar TOPOLLAJ

KRYETAR

Aleksandër PICA KU

Paraqiti Projektin:

Koordinator për Projektet Kabineti i Kryetarit: **Mark Ruçi**

Sektori për Integrimin Evropian dhe Projektet: P/Sek, **Gjovalin Marfana**

Drejtorja Juridike,: P/Sek, **Lorena Gjergji**



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3282 Prot.

Rrëshen, më 17.07.2026

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

**“PËR MIRATIMIN E DRAFT-MEMORANDUMIT PËR PARTNERITET DHE
BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLË NDËRMJET BASHKISË MIRDITË DHE KOMUNËS
NOVA RAČA, REPUBLIKA E KROACISË”**

Të nderuar Këshilltarë,

1. Qëllimi dhe nevoja e miratimit

Ky projektvendim paraqitet për miratimin e Draft-Memorandumit për Partneritet dhe Bashkëpunim të Ndërsjellë ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe Komunës Nova Rača të Republikës së Kroacisë. Memorandumi synon të krijojë një kuadër të qëndrueshëm institucional për zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet dy njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe për konkretizimin e tyre përmes projekteve, aktiviteteve dhe shkëmbimeve të përbashkëta.

Bashkëpunimi me një njësi vendore të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian krijon mundësi për shkëmbimin e përvojave, forcimin e kapaciteteve administrative, krijimin e partneriteteve ndërmjet institucioneve dhe komuniteteve vendore, si dhe përgatitjen e aplikimeve të përbashkëta në programe dhe fonde të Bashkimit Evropian.

2. Objekti dhe përmbajtja e Memorandumit

Memorandumi përcakton parimet, objektivat dhe format e bashkëpunimit për një periudhë pesëvjeçare. Fushat kryesore të parashikuara janë: planifikimi urban dhe zhvillimi territorial; zhvillimi ekonomik vendor dhe promovimi i investimeve; mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm; arsimi, trashëgimia kulturore, rinia dhe sporti; shëndetësia dhe mirëqenia sociale; turizmi dhe ekoturizmi.

Format e bashkëpunimit përfshijnë hartimin, aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta, veçanërisht në kuadër të programeve të Bashkimit Evropian; shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në qeverisjen vendore; krijimin e partneriteteve ndërmjet institucioneve arsimore e kulturore; zhvillimin e kontakteve ndërmjet komuniteteve të biznesit; si dhe organizimin e vizitave, forumeve, aktiviteteve kulturore dhe shkëmbimeve institucionale.

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al

3. Baza ligjore dhe procedura e miratimit

Neni 14, pika 4, i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, u njeh njësive të vetëqeverisjes vendore të drejtën për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi ndërvendor me njësi të vetëqeverisjes vendore të shteteve të huaja. Sipas pikës 3 të të njëjtit nen, marrëveshja miratohet nga këshillat përkatës të njësive që janë palë në të.

4. Efektet financiare

Miratimi dhe nënshkrimi i Memorandumit nuk krijon në vetvete detyrime financiare për Bashkinë Mirditë. Neni 8 i Memorandumit përcakton se çdo detyrim financiar ose juridik do të lindë vetëm nga marrëveshje, projekte apo akte të veçanta të lidhura në zbatim të tij.

Çdo aktivitet i ardhshëm që kërkon financim nga buxheti vendor do t’i nënshtrohet procedurave të veçanta të miratimit, planifikimit buxhetor dhe zbatimit sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

5. Përfitimet e pritshme

Miratimi i Draft-Memorandumit pritet të zgjerojë rrjetin e partneriteteve ndërkombëtare të Bashkisë Mirditë, të rrisë mundësitë për pjesëmarrje në projekte evropiane, të mundësojë shkëmbime të dobishme për administratën dhe komunitetin, si dhe të promovojë potencialet e Mirditës në fushën e turizmit, kulturës, zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit. Draft-Memorandumin e gjeni bashkëlidhur këtij relacioni

Në përfundim, duke vlerësuar interesin institucional dhe komunitar të këtij bashkëpunimi, i propozohet Këshillit Bashkiak Mirditë miratimi i projektvendimit dhe autorizimi i Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e Memorandumit dhe ndjekjen e procedurave për zbatimin e tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Koordinator për Projektet Kabineti i Kryetarit: **Mark Ruçi**

Sektori për Integrimin Evropian dhe Projektet: P/ Sek, **Gjovalin Marfana**

KRYETARI
Albert MELYSHI



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al



Nr. 3462 Prot
Datë 29.07.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 11322 Prot.

Tiranë, më 27.07.2026

Lënda: Mbi nënshkrimin e Marrëveshjes së Binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe Komunës Nova Rača, Kroaci.

MINISTRIT TË SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR

Tiranë

Për dijeni:

→ **BASHKISË MIRDITË**

Mirditë

Referuar informacionit të përcjellë nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Zagreb, më 23 korrik 2026, në Komunën Nova Rača, u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të Marrëveshjes së Binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe Komunës Nova Rača, me pjesëmarrjen e Ambasadores së Republikës së Shqipërisë në Kroaci, znj. Donika Hoxha.

Kjo marrëveshje përbën një zhvillim pozitiv në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore të dy vendeve dhe krijon mundësi për shkëmbimin e praktikave të mira dhe zhvillimin e nismave të përbashkëta në fushat e qeverisjes vendore, administrimit publik, zhvillimit rural dhe ekonomik, turizmit, kulturës, arsimit, si dhe shfrytëzimit të mundësive që ofrojnë fondet e Bashkimit Evropian.

Duke vlerësuar rëndësinë e kësaj nisme për forcimin e kapaciteteve vendore dhe thellimin e marrëdhënieve shqiptaro-kroate, ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe mbetemi të gatshëm për bashkërendimin e mëtejshëm institucional dhe lehtësimin e komunikimit me palën kroate

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





BASHKIA MIRDITË

MEMORANDUM PËR PARTNERITET DHE BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLË

Mes

BASHKISË MIRDITË

Përfaqësuar nga: Albert Mëlyshi, Kryetar i Bashkisë

Adresa: Sheshi "Abat Doçi", 4601 Rrëshen, Mirditë, Shqipëri

NIPT: K39004005W

dhe

KOMUNËS NOVA RAČA

Përfaqësuar nga: Darko Knežić, Kryetar i Komunës

Adresa: Trg Stjepana Radića 56, 43272 Nova Rača, Kroaci

OIB (ID Tatimor): _____

në vijim të quajtura "Palët", bien dakord të lidhin këtë Memorandum për Partneritet dhe Bashkëpunim të Ndërsjellë.

Neni 1.
Objekti i Memorandumit

Ky Memorandum përcakton parimet, fushat e bashkëpunimit, objektivat dhe aktivitetet e përbashkëta ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe Komunës Nova Raça, me qëllim zhvillimin dhe forcimin e marrëdhënieve institucionale, kulturore, sociale dhe ekonomike ndërmjet dy njësive të vetëqeverisjes vendore.

Neni 2.
Fushat e Bashkëpunimit

Palët do të mbështesin dhe zhvillojnë bashkëpunimin në fushat e mëposhtme:

- Planifikimi urban dhe zhvillimi territorial;
- Zhvillimi ekonomik vendor dhe promovimi i investimeve;
- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm;
- Arsimi, Trashegimi kulturore, Rinia dhe Sporti;
- Shëndetësia dhe mirëqenia sociale;
- Turizmi dhe ekoturizmi.

Neni 3.
Parimet e Bashkëpunimit

Palët e konsiderojnë bashkëpunimin në fushat e përcaktuara në nenin 2 të këtij Memorandumi si një kontribut të rëndësishëm për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre dhe shprehin gatishmërinë për konkretizimin e bashkëpunimit përmes projekteve, aktiviteteve dhe iniciativave të përbashkëta.

Neni 4.
Format e Bashkëpunimit

Për realizimin e objektivave të këtij Memorandumi, Palët bien dakord të nxisin:

- Bashkëpunimin në hartimin, aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta, veçanërisht në kuadër të programeve dhe fondeve të Bashkimit Evropian;
- Shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e qeverisjes vendore dhe adresimin e sfidave të përbashkëta;
- Krijimin e partneriteteve ndërmjet institucioneve arsimore, kulturore dhe organizatave të tjera me interes të përbashkët;
- Zhvillimin e kontakteve dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve të biznesit, me fokus të veçantë në turizëm, agroturizëm dhe ekoturizëm;
- Organizimin e vizitave, aktiviteteve kulturore, forumeve dhe shkëmbimeve institucionale.

Neni 5.
Kohëzgjatja

Ky Memorandum lidhet për një periudhë pesë (5) vjeçare nga data e hyrjes në fuqi. Memorandumi mund të rinovohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve.

Çdo Palë mund të tërhiqet nga ky Memorandum me njoftim paraprak me shkrim drejtuar Palës tjetër, pa cenuar aktivitetet dhe angazhimet e ndërmarra më parë.

Neni 6.

Hyrja në Fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët, pas miratimit nga organet përkatëse vendimmarrëse të secilës palë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kroacisë.

Ky Memorandum hartohet në tre kopje origjinale, në gjuhën shqipe, kroate dhe angleze, ku secila palë mban nga një kopje origjinale.

Neni 7

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i këtij Memorandumi do të zgjidhet në mënyrë miqësore përmes konsultimeve dhe negociatave ndërmjet Palëve.

Në rast se Palët nuk arrijnë një marrëveshje përmes konsultimeve, ato do të vazhdojnë dialogun institucional në frymën e partneritetit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, duke respektuar legjislacionin në fuqi të secilit shtet.

Neni 8

Dispozita Përfundimtare

Ky Memorandum shpreh vullnetin e Palëve për bashkëpunim dhe nuk krijon detyrime financiare ose juridike të detyrueshme përtej atyre që përcaktohen me marrëveshje, projekte ose akte të veçanta që mund të lidhen në zbatim të tij.

Çdo ndryshim ose plotësim i këtij Memorandumi bëhet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve dhe formalizohet me shkrim.

Palët angazhohen të veprojnë në frymën e partneritetit, respektit reciprok, transparencës dhe interesit të përbashkët për zhvillimin e komuniteteve që përfaqësojnë.

E BËRË

Në Nova Rača, më _____.2026

Në Rrëshen, më _____.2026

Nr. _____. Protokolli,

Nr. _____. Protokolli

KRYETAR I BASHKISË NOVA RAČA
DARKO KNEŽIĆ

KRYETAR I BASHKISË MIRDITË
ALBERT MËLYSHI

(firma dhe vula)

(firma dhe vula)